



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:043701

Datë: 11.03.2019

Numri i dokumentit: 00243116

P.nr.301/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bash. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. Sh. nga Suhareka dhe B. M. nga fshati S. Komuna Suharekë për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.II.nr.2609/15, të datës 21.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Pokurorit të Shtetit dhe të akuzuarve, me datë 01.03.2019 mori publikisht shpall, dhe me date 08.03.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.F. Sh., nga babai B. dhe nëna H. Sh. e lindur B., i lindur me 16.01.1983, në Suharekë rruga “B. 123” p.nr., ku edhe tani jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale.

2.B. M., nga babai Sh. dhe nëna Z. M. e lindur S., i lindur me 04.09.1993, në fshatin S. Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale.

JANË FAJTOR

Sepse me datë 11.08.2015, rreth orës 17:40, në fshatin R. Komuna e Suharekës, i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit Xh. G., në atë mënyrë që pas një mosmarrveshje që kishin mes tyre i akuzuari F. me të dëmtuarin, për shkak të mos kryerjes së punëve (instalimit të ujit) nga ana e të akuzuarit F. në objektin e të dëmtuarit, pas fjalosjes verbale mes tyre, situatë del jashtë kontrollit dhe fillon përleshja fizike mes të njëjtëve, ku i akuzuari F. me derën e kombit e godet në gjoks e në atë moment i dëmtuari rrëzohet në tokë dhe në ato momente i akuzuari B. M. duke parë përleshjen mes tyre, me një parë dara të ujit –mjet i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, e godet të dëmtuarin në kokë, si pasojë e së cilit të dëmtuarit Xh. G. i shkakton lëndime të rënda trupore.

-këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, 189 par.1 pika 1.1 të KPK-së,

Të akuzuarit **F. Sh.** i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Të akuzuarit **B. M.** i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohen të akuzuarit që në emër të ekspertizës mjeko ligjore të paguajnë shumën prej 20 euro secili veç e veç, në emër të shpenzimeve për viktimat e krimit shumën prej 30 euro secili veç e veç si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 euro veç e veç, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuar Xh. G., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.2609/15 të datës 21.04.2017, kundër të akuzuarit F. Sh. nga Suhareka dhe B. M. nga fshati S. Komuna Suharekë për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit të akuzuarit kanë theksuar se e kanë kuptuar në tërësi akuzën dhe e kanë pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka pasur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 11.08.2015, rreth orës 17:40, në fshatin R. Komuna e Suharekës, të akuzuarit F. Sh. dhe B. M. i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit Xh. G., në atë mënyrë që pas një mosmarrveshje që kishin mes tyre i akuzuari F. me të dëmtuarin, për shkak të mos kryerjes së punëve (instalimit të ujit) nga ana e të akuzuarit në objektin e të dëmtuarit, pas fjalosjes verbale mes tyre, situatë del jashtë kontrollit dhe fillon përlëshja fizike mes të njëjtëve, ku i akuzuari F. me derën e kombit e godet në gjoks e në atë moment i dëmtuari rrëzohet në tokë dhe në ato momente i akuzuari B. M. duke parë përlëshjen mes tyre, me një parë dara të ujit –mjete për shtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, e godet të dëmtuarin në kokë, si pasojë e së cilit të dëmtuarit Xh. G. i shkakton lëndime të rënda trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e

pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat u vihen në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarëve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit F. Sh. dhe B. M. formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KP-së, të cilën e kanë kryer në bashkëkryerje.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e që si rrethanë lehtësuese mori faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, duke nënkuptuar edhe pendesën e thellë të tyre, më pare nuk kanë qenë të dënuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74, moshën relativisht të re të të akuzuarve, rrethanat në të cilat e kanë kryer veprën penale, gjykata vlerësoi se të akuzuarit kanë qenë të provokuar nga i dëmtuari i cili gjithashtu është i akuzuar në të njëjtin rast me vepër të njëjtë penale por me lëndime të lehta ndaj të akuzuarit F. Sh., ndërsa rrethana rrethana posaqërisht rënduese nuk gjeti, andaj gjykata i shqiptoi të akuzuarit F. Sh. dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, dhe të akuzuarit B. M. i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, me bindje se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë të tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 paragrafi 4 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
P.nr.301/2017 të dt. 08.03.2019

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Qemal Suka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimi, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.